VENDIM
Nr.868, datë 27.10.2010

PËR SHPENZIMET DHE KOSTON EKONOMIKE PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR MBLEDHJEN E DETYRIMEVE NGA SUBJEKTET DEBITORE QË KANË PËRFITUAR NGA FONDI KUNDËRPARTI DHE "NON PROJECT GRAND AID", TË ARDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË E TË USHQIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi gjendje, prej 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekësh, i mbledhur nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë, për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, i vitit 2006, të përdoret për shpenzimet që nevojiten për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondet kundërparti dhe "Non Project Grand Aid", të ardhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë e të ushqimit.

2. Procedurat, efektet financiare dhe kostoja ekonomike për shpenzimet e çmontimit, për transportimin, magazinimin dhe ruajtjen e serrave me ngrohje e të linjave të përpunimit, të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave.

3. Mënyra e administrimit dhe e shpenzimeve të këtij fondi për çmontimin, transportimin, magazinimin dhe ruajtjen bëhet sipas tarifave ligjore në fuqi.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha